

1. Si paraqitet situata me eksportet së fundmi dhe përse eksportuesit po hasin vështirësi lidhur me analizat e produktit në kufi?

Eksportet vazhdojnë normalisht, dhe çdo shqetësim i ardhur nga bizneset lidhur për sa kërkohet jemi duke e adresuar në mënyrën e duhur.

2. Cilat produkte zënë peshën më të lartë të eksporteve bujqësore?

Produktet kryesore që zënë peshën më të lartë të eksporteve janë:

- perimet (kryesisht më shumë domate, trangulli, speci);
- frutat (mandarina, mollë, luleshtrydhe, gështenja),
- bimët dekorative dhe bimët medicinale (kryesisht më shumë sherebelë, dëllinjë).

3. Drejt cilave vende eksportojmë, si dhe sa po ndihmon certifikata fitosanitare?

Vendet ku eksportohet:

- o në rajon Kosovë, Serbi, Bosnje, Mal i Zi, Maqedoni e Veriut;
- o në vendet e BE-së si Greqi, Francë, Spanjë, Itali, Poloni, Gjermani, Kroaci, Qipro, Austri, Hollandë, Zvicër;
- o USA, UK, Ukrainë, Bjellorusi, Kore, Sri Lanka, Australi, Turqi.

“Certifikata fitosanitare për eksport” është dokumenti zyrtar i lëshuar nga shërbimi i mbrojtjes së bimëve i zonës nga ku është prodhuar, e cila tregon se kushtet fitosanitare të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera plotësojnë standardet e sigurisë fitosanitare (shëndetin e bimëve), të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

“**Certifikata fitosanitare**”, garanton që ngarkesa është e pastër nga dëmtues karantinore si dhe është i vetmi dokument që bën të mundur lëvizjen e ngarkesave jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Përmbajtja e Certifikatës fitosanitare është e njëjtë me modelin e Konventës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Bimëve.
